

Bilanci i energjisë elektrike

Tremujori III - 2024


Tiranë, më 26 Nëntor 2024: Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, energjia elektrike në dispozicion u rrit me 6,9 %.

Prodhimi neto vendas i energjisë elektrike në këtë periudhë u ul me 2,9 % duke arritur vlerën 1.565 GWh nga 1.611 GWh energji të prodhuar në tremujorin e tretë të vitit 2023.

Ky prodhim u realizua nga hidrocentralet publike në masën 69,5 %, nga hidrocentralet private dhe koncensionare në masën 18,7 % dhe nga të tjerë prodhues në masën 11,8 % të prodhimit neto vendas të energjisë elektrike.

Importi bruto i energjisë elektrike (energji në marrje), në tremujorin e tretë të vitit 2024, arriti vlerën 762 GWh nga 755 GWh që ishte në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar kështu një rritje me 1,0 %. **Eksporti bruto** i energjisë elektrike (energji në dhënie) arriti vlerën 282 GWh nga 453 GWh, duke shënuar një rënie me 37,8 % (tab.1).

Fig. 1 Energji në dispozicion, prodhimi neto vendas, importi dhe eksporti bruto



Për publikim 26/11/2024

Tab. 1 Balanci i energjisë elektrike

MWh

Treguesit	Tr. III 2023	Tr. III 2024
A Energji në dispozicion (A=1+2-3)	1.913.213	2.045.345
1 Prodhimi neto vendas (1=1.1+1.2+1.3)	1.610.934	1.564.702
1.1 Termocentrale	0	0
1.2 Hidrocentrale (1.2=a+b)	1.581.415	1.379.839
a Publike (a=a.1-a.2)	1.235.716	1.088.062
a.1 Prodhim bruto i hidrocentraleve publike	1.246.195	1.098.451
a.2 Humbje dhe konsum vetjak	10.480	10.389
b Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë	345.699	291.776
1.3 Të tjerë prodhues ¹	29.519	184.864
2 Importi bruto (energji në marrje)	754.934	762.297
3 Eksporti bruto (energji në dhënie)	452.656	281.655
B Konsumi i energjisë elektrike (B=1+2)	1.913.213	2.045.345
1 Humbjet në rrjet (1.1+1.2)	327.706	343.788
1.1 Humbjet dhe konsumi vetjak në transmetim	45.601	44.956
1.2 Humbjet në shpërndarje (1.2=a+b) ²	282.105	298.832
a Humbjet teknike në shpërndarje	210.164	233.923
b Humbjet jo teknike në shpërndarje ³	71.941	64.909
2 Përdorimi nga konsumatorët (2=2.1+2.2)	1.585.507	1.701.558
2.1 Familjarë	731.584	839.265
2.2 Jo Familjarë	853.923	862.293

¹ Të tjerë prodhues i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshiruar energjinë hidro dhe termo (fotovoltaikë, naftë, etj.)

² Detajimi i humbjeve teknike dhe jo teknike janë vlerësime të kryera nga operatorët që operojnë në fushën e energjisë elektrike.

³ Humbjet jo teknike përmbajnë edhe diferencat statistikore që rrjedhin nga mosdeklarimet e prodhimit dhe ndryshime nga koha e matjes së prodhimit e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.


Hidrocentralet publike, në tremujorin e tretë të vitit 2024, prodhuan 1.088 GWh nga 1.236 GWh të prodhuar në tremujorin e tretë të vitit 2023, duke shënuar kështu një rënie të prodhimit me 11,9 %.

Hidrocentralet private dhe koncensionare, prodhuan 292 GWh nga 346 GWh të prodhuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar një rënie të prodhimit të energjisë elektrike me 15,6 %.

Të tjerë prodhues, prodhuan 185 GWh nga 30 GWh të prodhuar në të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke shënuar një rritje të prodhimit të energjisë elektrike me 6.3 herë.

Shkëmbimi i energjisë elektrike (diferenca mes eksportit dhe importit bruto të energjisë), në tremujorin e tretë të vitit 2024 ka arritur vlerën negative prej 481 GWh ndërsa në tremujorin e tretë të vitit 2023 kishte gjithashtu një vlerë negative prej 302 GWh.

Fig. 2 Shkëmbimi i energjisë elektrike




Humbjet në rrjet arritën vlerën 344 GWh nga 328 GWh, duke shënuar kështu një rritje me 4,9 %, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2023.

Humbjet në transmetim janë ulur me 1,4 % ndërsa **humbjet në shpërndarje** janë rritur me 5,9 %.

Humbjet teknike në shpërndarje kanë shënuar një rritje me 11,3 %, ndërsa **humbjet jo teknike në shpërndarje** kanë shënuar një rënie me 9,8 %, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2023 (fig.3).


Fig. 3 Konsumi i energjisë elektrike, humbjet në rrjet dhe përdorimi nga konsumatorët



Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët, në tremujorin e tretë të vitit 2024, u rrit me 7,3 % duke arritur vlerën 1.702 GWh nga 1.586 GWh që ishte në tremujorin e tretë të vitit 2023.

Në rritjen e përdorimit të energjisë elektrike nga konsumatorët kanë ndikuar **konsumatorët familjarë**, ku kemi një rritje të konsumit të energjisë elektrike me 14,7 %, ndërsa energjia e konsumuar nga **konsumatorët jo familjarë** është rritur me 1,0 % (**fig. 4**).

Fig. 4 Përdorimi i energjisë elektrike nga konsumatorët



Metodologjia

Bilanci i Energjisë Elektrike jep informacion statistikor mbi prodhimin neto vendas të energjisë elektrike, shkëmbimin e energjisë elektrike, humbjet në rrjet si edhe konsumin final në vendin tonë. Statistikat për energjinë elektrike publikohen për një periudhë tremujore nga të dhënat mujore të grumbulluara prej burimeve administrative si:

- KESH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që prodhon, transformon dhe kryen shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike;
- OSSH sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që kryen shpërndarjen e energjisë elektrike, ndërtimin, funksionimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike;
- OST sh.a, shoqëri e pavarur shtetërore që operon në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike nga pikëpamja fizike dhe e shpërndarjes. OST sh.a garanton kapacitetet e nevojshme transmetuese për:
 - furnizimin e pa ndërprerë me energji elektrike të nënstacioneve të sistemit të shpërndarjes dhe konsumatorëve të energjisë elektrike të lidhur direkt në rrjetin e transmetimit;
 - transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vendit;
 - tranzitet dhe shkëmbimet e nevojshme me vendet e rajonit.

Përkufizimet e treguesve bazë

Energji në dispozicion i referohet sasisë së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhimi vendas i energjisë elektrike plus sasisë së importuar (përfshirë këmbimet) minus sasisë së eksportuar (përfshirë këmbimet).

Prodhimi neto vendas llogaritet si shumë e sasisë bruto të energjisë elektrike të prodhuar nga të gjithë prodhuesit në vend si prodhimi i hidrocentraleve, termocentraleve dhe prodhuesit e tjerë duke zbritur konsumin dhe humbjet vetjake në prodhim.

Energji termo i referohet energjisë elektrike të prodhuar nga termocentralet.

Energji hidro i referohet sasisë së energjisë elektrike të gjeneruar nga uji në hidrocentralet.

Humbjet dhe konsumi vetjak i referohet energjisë elektrike të përdorur nga veprimtaritë ndihmëse të stacionit të energjisë të lidhura direkt me prodhimin si psh. ftohje e ujit, shërbimet e stacionit të energjisë, ngrohje, ndriçim, etj.

Prodhues të pavarur privatë dhe koncesionarë u referohen prodhuesve private të energjisë elektrike të cilët në rastin e Shqipërisë përbëhen nga impiante ish-publike të privatizuara ose impiante të ndërtuara nga subjektet private vendase apo të huaja përmes kontratave koncesionare me Republikën e Shqipërisë. Këta prodhues lidhen direkt në sistemin e transmetimit dhe liqenohen nga Enti Rregullator i Energjisë (ERE) dhe mund të shesin kapacitete ose energji OST-së dhe OSSH-së, për të mbuluar humbjet në sistemin e transmetimit dhe shpërndarjes, si edhe tek klientë të tjerë.

Prodhues të tjerë i referohet prodhimit të energjisë elektrike nga burime të tjera të energjisë, duke përfshiruar energjinë hidro dhe termo.

Shkëmbimi i energjisë elektrike i referohet diferencës midis eksportit dhe importit të energjisë elektrike. Kjo përfshin edhe tranzitet dhe shkëmbimet (dhënie – marrje energjie) e nevojshme të energjisë elektrike me vendet e rajonit.

Konsumi i energjisë elektrike i referohet përdorimit nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë dhe sasisë së humbjeve në rrjet të energjisë elektrike.

Humbjet në rrjet përbëjnë humbjet në transmetim duke përfshirë edhe konsumin vetjak në transmetim si edhe humbjet në shpërndarje. *Humbjet teknike* në shpërndarje janë të vlerësuara nga OSSH sh.a. *Humbjet jo teknike* i referohen diferencës së humbjeve gjithsej në shpërndarje me humbjet teknike në shpërndarje si edhe të diferencave statistikore që rrjedhin nga ndryshimet në kohën e matjes së prodhimit, e cila është e sfazuar me të dhënat e shitjes apo konsumit.

Përdorimi nga konsumatorët është i barabartë me shumën e energjisë elektrike të konsumuar nga konsumatorë familjarë dhe jo familjarë.

Familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike në familje.

Jo familjarët i referohet sasisë së konsumit të energjisë elektrike nga sektorët e industrisë, transportit, agrikulturës, shërbimeve publike, etj. duke përfshiruar konsumin nga familjarët.